




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Rahovecit**  
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

**KRYETARI I KOMUNËS**  
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,  
Z. SMAJL LATIFI**


**NGA DATA 13.01.2025 DERI MË 17.01.2025**

| NR. | EMRI I VENDIMIT  | NR. I PROTOKOLLIT |
|-----|--|-------------------|
| 1.  | Vendim për Përfundimin e Marrdhënies së Punës.   | NRP-02-5169-2025  |
| 2.  | Vendim për formimin e komisionit për dhënie në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës. | NRP-02-5175-2025  |
| 3.  | Vendim për caktimin e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF).  | NRP-02-5177-2025  |
| 4.  | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë.   | NRP-02-5178-2025  |



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Komuna e Rahovecit**  
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.08/L-197, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **SELAMI ÇANTA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Mirëmbajtës i objekteve shkollore - shtëpiak në Drejtorinë komunale për Arsim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 23.2.2025.
2. **OBLIGOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave nga data 23.2.2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtori **SELAMI ÇANTA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Mirëmbajtës i objekteve shkollore – shtëpiak, në Drejtorinë Komunale për Arsim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 23.2.2025.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e Personelit ka konstatuar se punëtori i lartpërmendur, më datë 22.2.2025, arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit **SELAMI ÇANTA**, nga data 23.2.2025, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga se u tha më lart, kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

***Kopja e vendimit u dorëzohet:***

1. Punëtorit,
2. Drejtorisë për Arsim,
3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
4. Dosjes personale, dhe
5. Arkivit.



**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*  
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008”), dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, nenit 10 paragrafi 2 i Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21 të datës 28.5.2021, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës**

1. **Formohet** komisioni për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës në kuadër Drejtorisë për Shërbime Publike, në këtë përbërje:
  - 1.1. Venhar Topalli, kryesues,
  - 1.2. Fadil Bugari, anëtar,
  - 1.3. Bjondina Ramaj, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga parashtrimi i kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në terren dhe në fund të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë palën përfituese në bazë të kërkesave të parashtruara.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 197/21 të datës 28.5.2021.
4. Mandati i komisionit për dhënien në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës në kuadër Drejtorisë për Shërbime Publike do të jetë 1 (një) vit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Vendimi u dërgohet:**

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Shërbime Publike, dhe
- Arkivit.



**Shajir Latifi**  
**Kryetar i Komunës**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac / Municipality Orahovac  
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 1092, e datës 27.3.2015, kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF)**

1. Ekrem Bytyqi, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET:**
  - 1.1. Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF) në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të veprojë duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.
4. Ky vendim prodhon efekt juridik deri në përfundim të vitit fiskal 2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Ekrem Bytyqi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

- Ekrem Bytyqi,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92 të Statutit të Komunës, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. Saranda Rama** nga Rahoveci, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe në detyrat e punës: Zyrtare për Çështje Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, i aprovet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajsh, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajtë e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë nga data 8.1.2025 deri më 8.7.2025, ndërsa, 3 (tre) muajtë në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 9.7.2025 deri më 9.10.2025, ndërsa, 3 muajtë e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset *Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale*.

### A r s y e t i m

Punonjësja **Saranda Rama** nga Rahoveci, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Çështje Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nga data 8.1.2025 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit me Nr.34 të spitalit regjional të Gjakovës "ISA GREZDA".

Duke pasur parasysh që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizojë pushimin e lehonisë, data e shkuarjes në pushim të lehonisë konfirmohet sipas fletëlëshimit të spitalit.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Znj. Saranda Rama,*
- *Drejtore për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,*
- *Drejtore për Buxhet dhe Financa,*
- *Dosjes së punëtores, dhe*
- *Njësisë së Personelit.*

